



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.506/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Milena Gjeriq e Valon Totaj anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike të paditëses së mitur F.F. nga fshati ..., Komuna e Glogocit të cilën e përfaqëson me autorizim H.K. avokat, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim B.M., për shpërblimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2023/15 të datës 06.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.09.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e pjesërishëm të ankesës së të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2023/15 i datës 06.05.2019 sa i përket datës së llogaritjes së kamatës dhe gjykohet: kamata e gjykuar prej 8%, sa i përket dëmit material do të llogaritet nga dita e ushtrimit të padisë 27.08.2015 dhe ajo për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, datë 06.05.2019, kurse sa i përket pjesës tjetër të dispozitivit, ankesa e parashtruar REFUZOHET si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2023/15 i datës 06.05.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet pjesërisht kërkesëpapia e paditëses së mitur F.F. nga Drenasi, detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të dëmit të pësuar në aksidentin e trafikut me datë 02.09.2014, që është shkaktuar në Rr. Drenas-Komorani, në fshatin ..., t'ia paguaj si vijon: për dhembje fizike, shumën 3,500.00€, për frikë, shumën 3,000.00€, për ndihmë

dhe përkujdesje nga personi tjetër, shumën 147.00€, për ushqim të përforcuar, shumën 100.00€, për rehabilitim klimatik, shumën 80.00€. në pikën II, të dispozitivit detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumat e cekura në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kamatën ligjore në lartësi prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit, si dhe për shpenzime të procedurës shumën 948.00€, në afatin prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit ligjor. Në pikën III, të dispozitivit refuzohet pjesa e kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara në paragrafin një.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vendimit mbi shpenzimet e procedurës dhe vendimit mbi kamatën, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, duke aprovuar ankesën si të bazuar, aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2023/15 të datës 06.05.2019 ta ndryshoj dhe aprovoj shuma më të ulta si satisfaksion real në emër të kompensimit të dëmit për paditësen edhe atë shumën 1,500.00€, ndërsa pjesën e kërkesëpadisë mbi këtë shumë ta refuzoj si të pa bazuar, ose aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala paditëse.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja e mitur F.Z. ka parashtruar padi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..." me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, t'ia paguaj paditëses për dhembje fizike shumën 3,500.00€, për frikë, shumën 3,000.00€, për ndihmën e personit të tretë, shumën 210.00€, për ushqim të përforcuar, shumën 160.00€, për rehabilitim, shumën 300.00€, si dhe për shpenzime të shërimit, shumën 164.00€.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: raporti i policisë mbi aksidentin e datës 02.09.2014, dokumentacioni mjekësor-raporti i Qendrës Emergjente mbi aksidentin e datës 02.09.2014, ekspertiza e ekspertëve Dr. V.B. ortopede, Dr. S.B. psikiatre të datës 11.02.2019, dëgjimi

i ekspertes V.B. në seancën e datës 21.03.2019, ekspertiza e ekspertit Dr. A.G. ortoped-traumatolog dhe faturat e trajtimit mjekësor.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike: se aksidenti i datës 02.09.2014 ka ndodhur në rrugën Drenas-Komorani, në fshatin ..., përball shkollës fillore, si pasojë e lëshimeve të të siguruarit të të paditurës. Baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese por kontestuese janë lartësitë për disa forma të dëmit.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:e) ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë”.

Neni 319.1 i LPK-së: “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Nga gjendja e vërtetuar faktike, kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykimin, i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare. Kolegji gjen se, gjykata e shkallës së dytë, ka dhënë shpjegimet dhe arsyet e nevojshme dhe është bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është

përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kolegji vlerëson se ankesa e të paditurës e cila ka atakuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë shfaqet e pa bazuar pasi që gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e vendimit gjyqësor ka dhënë arsye të plota lidhur me mënyrën e vendosjes duke u mbështetur në provat e nxjerra, nga të cilat është vërtetuar se në aksidentin e komunikacionit të datës 02.09.2014, paditësja e mitur ka pësuar dëmin e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

Kolegji gjen se, në këtë çështje nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, por vetëm lartësia e saj. Nga ankesa e ushtruar kundër aktgjykimin të atakuar e paditura kontestimet e saj i ka adresuar në drejtim të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale duke theksuar se shumata e gjykuar janë të larta dhe nuk janë në përputhshmëri me praktikën gjyqësore në Kosovë dhe mënyrën e të vendosurit lidhur me këto kategori shpërblyese të dëmit. Në këtë pikë, kolegji gjen se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se duke marrë për bazë moshën e paditëses e cila në kohën e aksidentit ishte 12 vjeçe dhe me ekspertimin e kryer nga ekspertët mjekësor, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar shkallën dhe natyrën e lëndimeve e që në mënyrë të detajuar janë dhënë në ekspertizën e bërë nga ekspertët Dr. V.B. dhe Dr. S.B.. Kolegji gjen se, lëndimet e pësura nga paditësja e mitur, nga ana e ekspertëve mjekësor janë cilësuar si lëndime të rënda trupore. Në nenin 174 të LMD-së është përcaktuar se: *“Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”*. Kolegji nuk i ka miratuar pretendimet e të paditurës, për faktin se gjykata e shkallës së parë për një vendosje të tillë është bazuar në provat e shtjelluara, dhe se kompensimi i shumave që janë aprovuar është në proporcion me të mirën e cenuar dhe se një mënyrë e tillë e kompensimit, është një satisfaksion për paditësen dhe sa do pak do t’i mundësojë ta kalojë sa më lehtë atë që e ka përjetuar në këtë fatkeqësi të komunikacionit.

Kolegji pretendimet ankimore të të paditurës, sa i përket shpenzimeve të procedurës nuk i aprovon për faktin se lartësia e gjykuar lidhur me shpenzimet ne procedurë, përfaqëson shpenzimet e domosdoshme lidhur me vendosjen sipas kësaj çështje kontestimore. Këtë vendim gjykata e shkallës së dytë e ka mbështetur në nenin 454.1 të LPK-së, në të cilin është parashikuar që: *“Pala ka për detyrë që, pavarësisht nga ajo se cili e ka fituar procesin gjyqësor, t’ia shpërblej palës kundërshtare shpenzimet që ia ka shkaktuar me faj të vet ose me rastin që i ka ndodhur asaj”*.

Kolegji ka miratuar pjesërisht pretendimet ankimore të të paditurës dhe ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me llogaritjen e kamatës duke vendosur që kamata e gjykuar në lartësi prej 8%, sa i përket dëmit material të llogaritet nga dita e ushtrimit të padisë 27.08.2015, kurse sa i përket dëmit jo material nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, datë 06.05.2019, duke u bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën, të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e përgjithshme, të datës 01.12.2020.

Për arsyet e theksuar si më lartë, kolegji pretendimet ankimore të të paditurës i ka refuzuar si të pa bazuara dhe në këtë pjesë e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe e) të LPK-së është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.506/20 me datë 14.09.2021

Kryetari i kolegjit- gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj, d.v